

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues në përbërje nga gjyqtarët : Bashkim Hyseni, kryetar, Sahit Krasniqi dhe Musa Konxheli, anëtarë, me asistimin e procesmbajtëses Ardrita Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit A. F nga fsh., për veprën penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par 1 të KPK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut Prishtinë të evidentuar si PP:nr.482-06/2012, të dt. 24.09.2012. Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 24 dhe 28 janar 2013, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit, Rasim Malokut, të pandehurit, mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare për të pandehurin avokat Avni Ibrahim, të dëmtuarës V. Sh, mbrojtësit të viktimave I. T, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri :

A. F, i biri i A. dhe nënës A, mbiemri i vajzërisë së nënës A, i lindur më datë, në fshatin, i pamartuar, me profesion autolimar, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike, ka qëndruar në paraburgim prej datës 10.07.2012, deri më datë 28.01.2013.

Në kuptim të nenit 364 par. 1. nënpar.1. 3 të KPP-së:

LIROHET NGA AKUZA

Se prej vitit 2008 deri me 7 korrik 2012 në Ferizaj dhe Fushë Kosovë, e ka trafikuar të dëmtuarën V. Sh, e moshës madhore, në atë mënyrë që pasi është njoftuar me të në motel “.....”, në Ferizaj, ku punonte si valltare - kamariere, e ka mashtruar kinse për të bashkëjetuar, kështu që fillojnë të banojnë nëpër motele të ndryshme, e pastaj për një kohë e dërgon në shtëpinë e familjes së tij në fsh....., por për shkak të mosmarrëveshjeve kthehen prapë në, për të banuar në banesë me qëra, e për një kohë edhe në, por në vazhdimësi duke e keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht për ta detyruar që ti jepte parat që fitonte nga puna, të ofroj shërbime seksuale për klient, duke i’ a shitur sendet personale si telefona, zinxhir ari etj, e në një rast edhe duke i’ a djegur rrobat personale, duke e detyruar të kërkoj para nga motrat që punojnë jashtë Kosovës, në shumat prej 200 (dyqind), deri në 1000 (njëmijë) euro, kinse për operacione plastike, dhe shërim, me të cilat veprime i pandehuri e ka mbajtur në kontroll të vazhdueshëm të dëmtuarën, duke i’ a kufizuar lirinë, për të punuar, dhe të drejtën për lëvizje të lirë, dhe si pasojë e këtyre keqtrajtimit e dëmtuara disa herë ka ndërprerë bashkëjetesën për t’u vendosur në strehimoret kolektive në Prishtinë dhe Gjilan, kurse për muaj të tërë jeton e vetme nëpër banesa të ndryshme. Meqë i pandehuri në disa raste duke përdorur dhunë fizike i shkakton edhe lëndime trupore, dhe atë me datë 31 gusht 2010, pasi e sulmon fizikisht i shkakton lëndime trupore pasi e dëmtuara kishte lajmëruar një rast të dhunës në njësinë për mbrojtjen e viktimave, me datë 8 nëntor 2010, i shkakton lëndime trupore në kokë dhe i’ a merr 80 (tetëdhjetë) €, me ç’rast arrestohet i pandehuri dhe ndalohet nga policia për 72 orë. Mirë po me datë 11 nëntor 2010, shkon në banesën ku ishte e vetme e dëmtuara dhe e sulmon fizikisht duke e kanosur se do ta vras, për ta detyruar që ti japë 500 (pesëqind) €, kinse për ta paguar mbrojtësin, me datë 10 mars 2011, deri me datë 15 mars 2011, e keqtrajton fizikisht disa herë,

duke i shkaktuar lëndime trupore, me ç'rast i merr një telefon dhe një palë syze, me datë 22 shtator 2011, e ka kanosur se do ta vras se kishte lajmëruar rastin në polici dhe të njëjtën ditë i shkakton lëndime trupore duke i'a lidhë duart me lidhëse të këpucëve pasi kishte lajmëruar rastin e kanosjes, kurse rreth orës 22:00, të të njëjtës ditë i shkon në banesë dhe i kërkon 300 (treqind) €, mirë po meqë e dëmtuara nuk kishte para e sulmon me grushta dhe kaçavidë duke i shkaktuar lëndim trupor në pjesë të ndryshme të trupit dhe në organet gjenitale -vaginë, me ç'rast i'a merr një zingjir ari nga qafa, me datë 23 shtator 2011, rreth orës 12:30, e sulmon fizikisht deri sa e dëmtuara ishte në banesë e vetme, dhe i'a merr një telefon të markës Sony – Ericsson. Me datë 13 nëntor 2011, e sulmon fizikisht duke i shkaktuar lëndime trupore për ti kërkuar para, me datë 21 shkurt 2012, e keqtrajton fizikisht dhe psikikisht në banesë për ta detyruar ti jap 300 (treqind) €, dhe meqë e dëmtuara nuk kishte para e detyron ti kërkon nga një klient së paku 60 (gjashtëdhjetë) euro. Kurse derisa ka punuar në motel “.....”, në, e ka kërcënuar dhe keqtrajtuar disa herë derisa banonte në një banesë për ta detyruar ti ofroj shërbime seksuale klientëve, kështu që me një rast kur e dëmtuara kishte refuzuar një kërkesë për të ofruar shërbime seksuale për çmim 150 (njëqindpesëdhjetë) € e keqtrajton fizikisht, kurse me datë 7 korrik 2012, e keqtrajton fizikisht dhe psikikisht për ta detyruar që të sjell nga 100 (njëqind) € në ditë për shërbime që kryente si valltare - kameriere, me që rastin e dëmtuara e paraqet në polici kështu që i pandehuri arrestohet dhe caktohet masa e paraburgimit.

- me të cilën do të kryente veprën penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën të përshkruar më lartë.

-

E dëmtuara V. Sh nuk ka paraqitur kërkesë pasurore - juridike

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore

A r s y e t i m i

1. Historiku procedural

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë me aktakuzën PP. nr. 482-6/2012, të datës 24.09.2012, ka akuzuar të pandehurin A. F, për veprën penale trafikimi me njerëz nga neni. 139 par.1 të KPK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të evidentuar si KA. nr. 741/12 të datës 12.10.2012, është konfirmuar aktakuza ndaj të pandehurit, duke hapur në këtë mënyrë rrugën për shqyrtimin gjyqësor.

Trupi gjykues duke vepruar sipas kësaj akuze, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datat 24 dhe 28 janar 2013, në të cilat i pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe shqyrtimi ka vazhduar me prezantimin e provave si :

- Dëshmia e të dëmtuarës V. Sh dhënë në hetuesi (policit) më datë 09.07.2012, në Prokurorin e Qarkut në Prishtinë më datë 11.09.2012, si dhe dëgjimi i saj i drejtpërdrejtë në shqyrtimin gjyqësor;

- Raporti nga masat e përgjimit me sms nga numrat e telefonit të pandehurit dhe të dëmtuarës;
- Dëshmia e dëshmitarit N. D.
- Propozim akuzat e Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.1580/2010, e datës 4 mars 2011, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni. 153, par.4 lidhur me par.1, nënpar.4 të KPK-së.
- Aktakuzë e Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.1620/2010, e datës 18 maj 2011, për veprën penale detyrimi nga neni.267 par.1 të KPK-së.
- Propozim akuzë e Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.607/2011, e datës 02.09.2011, për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni. 153 par.4 lidhur me par. 1 nënpar.2 dhe 4 të KPK-së.
- Propozim akuza e Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.2298/2011, e datës 26.04.2012, për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni. 153 par.4 lidhur me par. 2 dhe 1. nënpar. 4 të KPK-së.
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P. nr.210/2012, e datës 15 mars 2012, për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni. 153 par.1 nënpar. 4 të KPK-së.
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P.nr.1275/12, e datës 14.11.2012, për veprën penale kanosja nga neni. 161 par. 2 të KPK-së.

2. Shqyrtimi gjyqësor dhe deklaratimet e palëve

Prokurori shtetit Rasim Maloku, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se nga provat që janë prezantuar, dëshmia e të dëmtuarës, dhe dëshmitë e lexuara të saj të dhëna në polici dhe

prokurori, provat materiale, komunikimi përmes sms-ve, me të pandehurin, lëndët për vepra penale të dërguara në këtë gjykatë, për periudhën e përmendur, dhe pjesërisht nga vetë mbrojtja e të pandehurit, është vërtetuar kjo gjendje faktike, se i akuzuari dhe e dëmtuara në periudhën kohore të përfshirë në aktakuzë, kanë krijuar një bashkëjetesë fiktive, se i akuzuari, në vazhdimësi ka ushtruar dhunë fizike dhe psikike, me qëllim që të dëmtuarën ta obligoj ti sjell para nga puna që ka kryer si valltare dhe kamariere, duke i marrë në disa raste edhe sendet personale, si zinxhirë qafe, telefona, e në një rast edhe duke ia djegur rrobat personale, që e dëmtuara ti plotëson kërkesat që i ka parashtruar i akuzuari, i akuzuari, në disa raste kërkon nga e dëmtuara, që të ofroj shërbime seksuale për klient dhe në momentin kur ajo refuzon keqtrajtohet fizikisht dhe psikikisht, kurse, dy ditë para arrestimit me datë 7 korrik 2012, e keqtrajton fizikisht për ta detyruar që çdo ditë ti sjell nga 100 (njëqind) euro për shërbimet që do të kryente deri sa punonte.¹

Andaj në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale trafikim me njerëz nga neni. 139 par.1 të KPK-së, duke i propozuar trupit gjykues që të pandehurin ta shpall fajtor për këtë vepër penale dhe t'i shqiptoj dënim të paraparë me ligj.

E dëmtuara V. Sh në fjalën përfundimtare deklaron se; mbetet pranë deklaratës së dhënë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 24 janar 2013, i vije keq se ka dhënë deklaratë të rrejshme në polici, ndërsa rrethanat të cilat i ka përmendur, duke punuar nëpër kafene ka mësuar se si trafikohen femrat, dhe gjithë këtë ia ka m' veshur A., nuk paraqet kërkesë pasuroro-juridike dhe i kërkon falje të akuzuarit për deklaratat e rrejshme.

¹ Fjala përfundimtare e palëve – prokurorit në procesverbalin e shqyrtimit e gjyqësor i datës 28.01. 2013

Ndërsa e ka përsëritur arsyen pse e ka bërë deklarin e rrejshëm, është se A. e ka tradhtuar, gjithashtu arsyeja tjetër është e ka bërë se nuk e ka lënë të punoj nëpër kafenetë ku edhe ka punuar.

Mbrojtësi i viktimave I. T, në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se i përkrahë fjalët e prokurorit në tërësi kundër të akuzuarit për veprën penale trafikimi me qenie njerëzore, nga të gjitha deklaratat që viktima i ka dhënë në polici ku gjithsej janë afër 8 (tetë) deklaratat, ekzistojnë të gjitha elemente ku e ka detyruar të punoj nëpër kafene ti sjell 50 (pesëdhjetë) apo 150 (njëqindpesëdhjetë) € në ditë, e kur e dëmtuara nuk ka mund ti siguroj ato të holla, e ka rrahur, kanë qenë të informuar për këtë rast, e kanë strehuar disa herë viktimën, dhe i njëjti ka vazhduar me të njëjtin avaz të vjetër duke e detyruar të punoj nëpër kafene të ndryshme, në këtë mënyrë kemi të bëjmë me kërcënim, ku viktima në këto moment ka dhënë deklaratë të rrejshme në shqyrtimin gjyqësor që është mbajtur me datë 24 janar 2013, kundër dëshirës dhe vullnetit të saj.

Mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare avokat Avni Ibrahimimi në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se aktakuza mbështetet në shqyrtimin e sotëm në deklaratën e të dëmtuarës V. Sh, e cila është dhënë më 09 korrik 2012, e dëmtuara pas 2 (dy) muaj në prokurori, ka revokuar në tërësi deklaratën e dhënë që i referohet rrethanave se kinse i akuzuari ka kërkuar që të ofroj shërbime seksuale, edhe në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë detaje shpjegoi se pse i ka dhënë deklaratat e rrejshme në polici, të cilat janë të logjikshme dhe ka shpjeguar shumë qartë arsyen pse e ka bërë, e që është nga xhelozia. Gjithashtu nuk rezulton se i pandehuri ta ketë shtyrë të punoj, e aq më tepër të ofroj shërbime seksuale, ka propozuar që të lirohet nga akuza.

3. Analiza e Ligjit Material

Trupi gjykues para se të vlerësoj provat e administruara e konsideron të nevojshme të bëjë analizimin e veprës penale trafikimi me njerëz.

Neni 139 i KPK-së, e përkufizon trafikimin me qenie njerëzore se i përmban 3 (tre) elemente :

1. Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave;
2. Me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës, apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave, apo përfitimeve për ta arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër;
3. Me qëllim të shfrytëzimit. Shfrytëzimi është përkufizuar: “si shfrytëzim i prostitucionit ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve”.

Këto 3 (tre) tipare të dallueshme mund të shihen si element i “veprimit (aktit)” (rekrutimit, transportimit, transferimi, strehimi ose pranimi i personave).

Elementi i mjetit (kërcënimi ose përdorimi i forcës apo forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për ta marr pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër).

Dhe elementi “mental” (qëllimi i shfrytëzimit). Dy elementet e para kërkojnë veçanërisht ekzistimin e *actus reus*, ndërsa elementi i tretë kërkon ekzistimin e *mens rea*. Këto elemente do të shqyrtohen në paragrafët e mëposhtëm:

1) Elementi i “veprimit”

Elementi i parë *actus reus* mund të plotësohet nëpër mes njëres nga pesë veprimet me radhë, respektivisht : (i) rekrutimi; (ii) transportimi; (iii) transferimi; (iv) pranimi; (v) strehimi i personit;

2) Elementi “i mjetit”

Elementi i dytë *actus reus* i veprës penale të trafikimit është i ashtuquajtur i element i mjetit. Ky kusht aplikohet vetëm nëse viktimja e trafikimit është e moshës madhore.

Posaçërisht në nenin 139 të KPK-së, kërkohet që kryesi të ketë kryer veprimet në raport me viktimën: me mjete të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të ndonjë pozite të ndjeshme, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesës për të arritur pëlqimin mbi personin tjetër. Prandaj, vetëm transferimi, pranimi, strehimi, rekrutimi ose transportimi i personit nuk përbën në vete veprën penale të trafikimit.

3) Elementi mental:

Komponenti i fundit i veprës penale të trafikimit është kushti subjektiv – shfrytëzimi i qëllimshëm i viktimës. Ashtu siç është paraparë në nenin 139 të KPK-së, shfrytëzimi përfshihet

por nuk përkufizohet në prostitucionin, shërbime seksuale, punë të detyruar, skllavërim, robërim, ose heqje të organeve. Qëllimi i shfrytëzimit është elementi mental - dolus specialis, me fjalë të tjera veprimi dhe mjeti te kryesi duhet të kenë për qëllim shfrytëzimin e viktimës, si rrjedhim, nëse veprimet dhe mjetet të kryera nga kryesi janë bërë me qëllim tjetër nga ai, me qëllim të shfrytëzimit të viktimës, vepra penale e trafikimit nuk është kryer. Andaj duhet të ekzistojnë provat të cilat vërtetojnë që të 3 (tre) këto komponentë të kësaj vepre.

4. Vlerësimi i Dëshmive dhe të Gjeturat e Gjykatës

Teza e prokurorit është e bazuar substancialisht në dëshminë inkriminuese të të dëmtuarës V. Sh, të dhënë në procedurën hetimore më 09 korrik 2012.²

Megjithatë nga procesverbali i kësaj date konstatohet se e dëmtuara *nuk është udhëzuar për pasojat e dëshmisë së rrejshme në kuptim të nenit 164 paragrafi 2 të KPPK-së* (Kod i cili ishte i aplikueshëm në kohën e intervistimit), ndër të tjera, se është e obliguar të flas të vërtetën që i bëhet çdo dëshmitari para intervistimit të tij, dhe një paralajmërim i tillë është i detyrueshëm.

E dëmtuara më pas me datë 11.09.2012, ka dhënë një deklaratë e cila është e kundërt me deklaratën e mëparshme dhe esencialisht e pa pajtueshme me faktet që i ka deklaruar në deklaratën e më pazëshme.³ Gjithashtu dëshmia e saj në shqyrtimin gjyqësor është identike me atë të deklaruar te prokurori.⁴ Një ndryshim i tillë në raport me dëshminë e parë natyrisht kërkon një vlerësim të kujdesshëm në lidhje me besueshmërinë e këtyre deklaratave si dhe verifikimin e të gjitha rrethanave.

² Procesverbali i datës 09. 07. 2012 mbi dëgjimin e të dëmtuarës V. Sh në hetuesi (polici)

³ Procesverbali i datës 11. 09. 2012 mbi dëgjimin të dëmtuarës V. Sh në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë

⁴ Dëshmia e të dëmtuarës në procesverbalin e shqyrtimin gjyqësor më datë 24. 01. 2013

Trupi gjykues vlerëson se dëshmia e një dëshmitari nuk mund të vlerësohet si e izoluar por e njëjta duhet të analizohet në kontekst dhe lidhshmëri me provat tjera.

E dëmtuara që nga viti 2003, ishte angazhuar të punoj si kameriere dhe valltare në kafene të ndryshme dhe këtë po e vazhdonte ta bënte edhe tani, dhe nuk kishte ndonjë profesion tjetër. Në vitin 2008, është njoftuar me tani të pandehurin dhe ka krijuar bashkësi jashtëmartesore, një kohë ka jetuar të pandehurin në fshatin Koshare, dhe më pas nëpër banesa të ndryshme me qëra.

Gjithashtu nuk ekzistojnë dëshmi se kjo bashkësi e tyre të këtë qenë fiktive dhe për më tepër të jetë krijuar me qëllim të shfrytëzimit të të dëmtuarës, dhe kjo mbetet vetëm një supozim hipotetik dhe i pambështetur në faktet e çështjes.

Me qëllim të vlerësimit të drejt dhe të gjithanshëm të besueshmërisë së dëshmisë së saj, është e nevojshme që e njëjta të analizohet edhe në raport me komunikimet të cilat i ka pasur për mes *sms-ve*, me të pandehurin dhe njëkohësisht komunikimi i të pandehurit me persona të tjerë, i cili përgjim është bërë në kuadër të masave të fshehta të hetimit, të bazuar në urdhëresën e lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Në një komunikim për mes *sms-ve* të dërguar nga numri i saj (.....) numri i të dëmtuarës, në numrin e të pandehurit (.....), tekstualisht shkruan si vijon :

- Më 05.06.2012, e dëmtuara i shkruan të akuzuarit: “ *ma jep edhe nja te lus vetëm për atë që te kam dashtë me shpirt ta ha zemren ma jep edhe nje muns mos te thojne kto magjupe e arriem qellimin ton*” ;
- Më 25.06.2012, ora 19.43, e dëmtuara po ashtu nga numri i lartë cekur, i shkruan të akuzuarit : “*He more tit nuk i prita kto prej teje me ke trathtu se jam nis prej vetes sprish pun syn me fal që ta shajta dashnoren epo te pengoj me fal per kejt me fal*”;
- Më 25.06.2012 ora 19.43, e dëmtuara i shkruan të akuzuarit: “*që te deshta ma shum se veten*”;
- Më 25.06.2012, ora 18.11, e dëmtuara i shkruan të akuzuarit: “*jet ma i miri kupto që nuk shoh dikan tjetër pos teje se kam meritu mem trathtu per ni magjupe te smut pse po me lendon veq se munesh dhe edi që te du*” ;
- Më 25.06.2012, ora 15.26, nga numri i të dëmtuarës drejtuar në numrin e të pandehurit shkruan “ *Kthev osyn veq edhe ni her te lus ma nuk gaboj jetojm ku te dushe ti ama edhe nje muns te lus*”

Ndërsa komunikimi nga numri i të pandehurit në numrin e të dëmtuarës, ndër të tjera i shkruan :

- Më datë 25.06.2012, ora 20:37, i pandehuri i shkruan të dëmtuarës; “*Un te kam than që mke lodh me ato sene ti që iban ato jan sene pa vler po ti nuk mke kuptu kurr e nuk je nal kurr tkam than asht shanca e fundit*”;
- Më 26.06.2012, ora 04:13, i pandehuri i shkruan të dëmtuarës: “*Tmak pas than mos me merr ne qaf po ti ke mendu që un po foli kot tasht un duhet me nejt qyshav eti mthu ajde ne fush kosov nuk muj me ardh*” ;

- Më 10.07.2012, ora 15:30, i pandehuri i shkruan të dëmtuarës: *“Mir ja ke bo shum per 1.200 ero tesha qe ti kam djeg je tu u munu me ma rras mue me mshti ne burg edhe qe kam shku me riten po njo dije qe ka zot”*;
- Në sms-in e datës 10.07.2012, ora 15:40, i akuzuari i shkruan të dëmtuarës; *“Ti je ajo qe duhesh me shku ne burg se sen nuk tkam bo moj e pa bes po nuk ka sen qe nuk kalon nuk jam ipari shum e njerin e ke marr ne qaf po ka zot”*.

Dëshmia e tillë konsiderohet objektive për këto arsye :

- I pandehuri dhe e dëmtuara nuk ishin në dijeni se komunikimet e tyre po përgjoheshin;
- Si të gjitha bisedat telefonike në parim, po e trajtonin si një komunikim privat (konfidencial);
- Bisedat ishin spontane dhe të natyrshme;
- Nuk është vënë në pyetja saktësia apo vërtetësia e saj;
- Aspektet e tilla i japin shkallë të lartë të vërtetësisë dhe besueshmërisë kësaj dëshmie.

Nga komunikimet e të dëmtuarës me të pandehurin qartazi mund të konkludohet se ka ekzistuar lidhja e dashurisë mes tyre edhe për kundër problemeve që e ka karakterizuar këtë lidhje.

Trupi gjykues vlerëson se komunikimet e bëra përmes sms - ve pasqyrojnë raportin real që ka ekzistuar mes tyre dhe njëkohësisht tregojnë gjendjen emocionale të irrituar të të dëmtuarës,

si rezultat se kishte bindjen se i pandehuri po e braktiste dhe po e tradhtonte me një femër tjetër – R....

Gjatë asaj periudhe kohore i pandehuri po shkëmbente sms me përmbajtje dashurie, me numrin, për të cilin konfirmohet se është numri i një femre të quajtur R... nga Sh..... Rrethanat e tilla konfirmojnë bindjen e të dëmtuarës mbi pretendimet se po braktisej nga i pandehuri.

Arsyet të cilat janë dhënë për ndryshimin e dëshmisë së të dëmtuarës dhënë në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor, në raport me deklaratën inkriminuese për të pandehurin e dhënë më datë 09.07.2012 janë konsistente, logjike dhe janë në harmoni me provat e tjera e në veçanti me komunikimet që i kanë pasur në periudhën para - denoncuese me të pandehurin.

Aspektet të cilat i japin kredibilitet dëshmisë së të dëmtuarës të dhënë në prokurori dhe më pas në shqyrtim gjyqësor janë si më poshtë:

- Është se asnjëherë nuk ka mohuar se ka pasur problem me të pandehurin, dhe madje se është ushtruar dhunë ndaj saj;
- E njëjta nuk është një person me përgatitje profesionale në fushën juridike, për të dhënë *deklaratë selektive* në mënyrë që në të, të mos përfshihen elemente të veprës penale të trafikimit;
- Elementet e trafikimit shpesh janë të paqarta edhe për vetë profesionistët e lëmisë penale, andaj opsionet alternative të shpjegimeve të ndryshimit të dëshmisë së saj duken të mbesin supozime të pambështetura dhe jo bindëse.

Prandaj trupi gjykues e vlerëson si të besueshme dëshminë e të dëmtuarës në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësorë

Dëshmia inkriminuese e të dëmtuarës e datës 09.07.2012 nuk mund të konsiderohet e besueshme për arsyet e përmbledhura si më poshtë:

- Nuk mbështet në dëshmi të tjera objektive dhe të pranueshme;
- Është në kundërshtim me të dhënat e siguruar përmes masave të fshehta të hetimeve;
- Raporti i komunikimit i pandehur - e dëmtuar përmes sms – ve, tregon se e dëmtuara po e ndiente se po e tradhtonte personi me të cilin po bashkëjetonte;
- E dëmtuara në një gjendje të tillë fillimisht po përpiqej që me çdo kusht ta rivendoste dhe ri konsolidonte lidhjen me të pandehurin;
- Frustrimi i saj po ngritej si rezultat se nuk po arrinte sukses;
- Po shprehte një urrejtje ndaj femrës me të cilën po besonte se po shoqërohej i pandehuri, duke e quajtur edhe me emra përrulës;
- Të gjitha këto po ushqenin një motiv xhelozie të lartë tek e dëmtuara;
- Personaliteti i dëmtuarës tregon për një karakter me labilitet disponimi, që në momente të caktuara të indisponimit të saj, mund të bëjë deklaratë akuzuese të cilat i konsideron se janë më të dëmshme për oponentin e saj;
- Nuk ekziston ndonjë komunikim që do të ishte inkriminues për të pandehurin në drejtim të veprës penale të trafikimit, si p.sh që ti ofroj shërbime seksuale me pagesë, që të punoj në mënyrë të detyruar dhe përfitimet të i'a dorëzoj të pandehurit.

Në vlerësimin e vërtetësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së një dëshmitari me një personalitet dhe tipare të tilla në procedurën penale, gjithmonë kërkohet një kujdes i lartë dhe dëshmia nuk mund të shkëputet dhe të trajtohet pa ndërlidhje me integritetin dhe vetitë e dëshmitarit.

Trupi gjykues vlerëson, se është e natyrshme që rastet kur ekzistojnë bashkësitë martesore apo jashtëmartesore, personat që kanë krijuar këto bashkësi të ndihmohen reciprokisht mes vete dhe të ekzistojnë një shkallë e caktuar e solidaritetit dhe jo çdo ndihmë e njërit prej bashkëshortëve të cilësohet se është duke u shfrytëzuar me qëllim të eksploatimit të tij apo saj pa pasur prova bindëse.

Dëshmitari N. D ka deklaruar se V. Sh e njeh për afërsisht dy muaj, atë e kam njoftuar përmes pronarit të objektit Nj. B, i cili ka thënë se njehë V..., dhe qenka mire që ta marri si punëtore i'a dha numrin e telefonit kështu që pas tri dite kur kam shkuar në lokal e ka parë V... kishte ardhur dhe kishte filluar me punua.

Kështu që ka filluar V.... duke biseduar shpesh në telefon me A.... dhe duke i dhënë raport se çka është duke punuar. Një ditë V..., e ka thirr në telefon që të vijë unë në Ferizaj dhe ta marr atë pasi që nuk po mundet me në punë ku më tha se do ta paguaj rrugën pasi që erdha në Ferizaj, në një lokal që mirë nuk më kujtohet aty e pash se V..... ishte me një person A...., dhe një femër tjetër e cila ishte nga Sh..... ku që të tretë thanë se po vijnë në F..... Pasi që i ka marrë që të tre dhe shkuan në lokal ka biseduar me V..... se ka nevojë edhe për punëtore të tjera atëherë V..... i ka thënë se mund të punoj si kamarierë dhe shoqja e saj nga Sh... ka njohuri pasi që V.... ishte duke banuar në F... atëherë edhe A..... ka filluar duke banuar me V.....n, gjatë kohës diku një muaj ditë që ka qëndruar A.... në banesë ka ardhur në lokal 3 deri

4 (tre deri katër) here. Gjatë qëndrimit të tij në lokal kishte pirë nga një birrë, gjatë kohë qëndrimit në lokal ishte ulur në një tavolinë i vetëm, dëshmitari shton se ka vërejtur se V...., i kishte thënë se përse po vjen në lokal se po i pengon, A.... nuk i ka dhënë asnjë përgjigje, ndërsa V.... i ka thënë se është në hall dhe se ai po e rrah. Arsyeja ishte se V.... për kontaktin me sms-së dhe thirrjet që i kishte me personat e tjerë është dashur ti arsyetohet A..... dhe të japë llogari për bisedat që i bënte, A..... e kishte mbajtur nën kontroll dhe ka dashur të dijë se çka është duke vepruar V.....⁵

Trupi gjykues konsideron se nga dëshmia e këtij dëshmitari nuk mund të nxjerrët ndonjë konkluzion relevant që do të mbështeste eventualisht ndonjë përfundim inkriminues për të pandehurin, si sa i përket rekrutimit, apo shfrytëzimit të dëmtuarës të cilat pretendohet në akuzë. Fillimisht është e qartë dhe nuk ka të dhëna se i pandehuri po njihej me këtë dëshmitar dhe se kishte ndonjë rol që e dëmtuara të punonte në motelin e tij “.....” në F..... Gjithashtu nuk ka ndonjë informacion nga ky dëshmitar se e dëmtuara po detyrohej nga i pandehuri që të punoj apo të ofroj ndonjë shërbim seksual apo ndonjë formë tjetër e shfrytëzimit, ndërsa shprehja kontroll e përdorur nga dëshmitari nuk mund të nxjerrët ndonjë përfundim që të ketë në kuptim të trafikimit, por nga konteksti, mund të kuptohet më tepër se ai po interesohej se me kë po shoqërohej e dëmtuara në cilësinë e një personi që shpreh interesim për partnerin me të cilën bashkëjeton .

4.1.Trupi gjykues do të trajtoj në veçanti riformulimin e përshkrimit faktik të dispozitivit të akuzës, respektivisht veprimet inkriminuese të të pandehurit të transportuara nga akuzat dhe aktgjykimet e formës jo të prerë .

⁵Procesverbal i datës 16. 07. 2013 mbi dëgjimin e dëshmitarit N. D

Praktika e përdorur nga prokurori që veprimet inkriminuese të cilat i përshkruhen në akuzat e ngritura kundër të pandehurit për vepra të tjera penale të transportohen tani në dispozitivin e akuzës, për të fuqizuar teorinë e rastit të tij është e papranueshme.

Për faktin se një qasje e tillë do të shpiente në shkeljen e prezumimit të pafajësisë të paraparë në nenin. 6 paragrafin. 2 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat dhe Lirit e Njeriut, Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht nenit. 31 paragrafi. 5, Kodit të Procedurës Penale paragrafit. 3.

Në të kundërtën, do të supozohet se i pandehuri i ka kryer veprat penale që ngarkohet me akuzat e ngritura ende pa i'u nënshtruar vlerësimit gjyqësor dhe pa marrë formën e prerë vendimi përkitazi me këto akuza dhe aktgjykime (të formës jo të prerë) dhe kjo do të ishte thjesht një supozim i fajësisë.

Nga aktgjykimet (Gjykatës Komunale në Ferizaj) të administruara vetëm aktgjykimi P. nr. 544/10, është i formës së prerë që i referohet ngjarjeve më 31.10.2010, ka të bëjë me veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par. 1 nënpar.4 të KPK-së për të cilën është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 28 ditëve. Aktgjykimi P.nr.210/12, është në procedurën ankimore, i referohet ngjarjes të datës 30.11.2011 dhe 21.02.2012, ka të bëjë për dy vepra penale lëndim i lehtë trupor neni.153 par.1 nënpar.4, është gjykuar me dënim unik burgimi me kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj. Aktgjykimi P.nr.1275/12 , i referohet ngjarjeve të datës 22.09.2011, për veprën penale kanosja nga neni.161 par.1 të KPK-së është gjykuar me 150 (njëqind e pesëdhjetë) € (urdhër ndëshkimor), dhe nuk është i formës së prerë.

Akuzat janë të Prokurorisë Komunale në Ferizaj :

Propozim akuza PP:nr.607/2011, e datës 02.09.2011, i referohet ngjarjes 10.03.2011, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni.153 par. 4 lidhur me par.1 nënpar.2 dhe 4 të KPK-së. Propozim akuza PP:nr.2298/12 e datës 26.04.2012, i referohet ngjarjes së datës 22.09.2012, ka të bëjë me veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni.153. par.4 lidhur me par.2 dhe 1 nënpar.4 të KPK-së. Propozim akuza PP:nr.1580/10 e datës 4 mars 2011, i referohet ngjarjes së datës 08.11.2010 ka të bëjë për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni.153.par.4 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së.

Aktakuza PP:nr:1620/10 e datës 18.05.2011, i referohet ngjarjes se datës 11.11.2010, për veprën penale detyrimi nga neni.267 par.1 të KPK-së.

Trupi gjykues vlerëson që nën dritën e këtyre rrethanave të cekura më lart, si të nevojshme që t'i referohet praktikës së Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, pasi që në kuptim të nenit. 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut bëhet në harmoni me vendimet e kësaj Gjykate.

Prezumimi i pafajësisë nga ana e GJEDNJ-së është trajtuar në shumë raste ndër to edhe në **rastin *Allenet De Ribemont v. Francë, aktgjykimi i datës 10.02.1995, seria A, NO.308***, ndër të tjera theksohet *“E rëndësishme është se prezumimi i pafajësisë nga neni.6 paragrafi.2 të KEDNJ-së, nuk përfshinë ndalesën që gjykata të informohet me të dhëna mbi çështje gjyqësore të të pandehurit nga evidenca e të dënuarve. Në parim gjykatat nacionale mund të informohen mbi të gjitha rrethanat, të cilat janë të ndërlidhura me personalitetin e të pandehurit dhe që mundë të kenë ndikim në matjen e dënimit, por jo në vërtetimin e përgjegjësisë së tij penale “.*

Rrjedhimisht sipas bindjes së trupit gjykues, në rastin konkret prokurori në këtë mënyrë, po tentonte të provonte përgjegjësinë penale të pandehurit për veprën për të cilën po akuzohet .

Gjithashtu në një rast tjetër për të kuptuar më mirë shkallën e shtrirjes së këtij prezumimi kjo gjykatë në **rastin Nolkenbockhoff-aktgjykimi i GJEDNJ-së, i datës 25.08.1987, seria A, 123,** shprehet *“I pandehuri ka vdekur pasi që është marrë aktgjykimi dënues, kundër të cilit ka ushtruar ankesë. Trashëgimtarët e tij kanë kërkuar nga shteti kompensimin e shpenzimeve të mbrojtjes gjatë procedurës, mirëpo gjykata Gjermane kërkesë padinë e tillë e ka refuzuar me arsyetimin se gjykata e shkallës së dytë sigurt se do të kishte me e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë”*. Rrjedhimisht GJEDNJ, ka konstatuar se me një qëllim të tillë është shkelur prezumimi i pafajësisë të cilin e garanton neni.6 paragrafi. 2 të GJEDNJ-së.

4.2. A është e mjaftueshme një deklaratë inkriminuese e siguruarë në procedurën paraprake për një vendim fajësie nën dritën e dispozitës së nenit 123 par. 3 të KPP-së ?

Deklarata në procedurën paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurën paraprake, urdhrat për paraburgim dhe aktakuzën.

Gjithashtu pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrjen e tërthorta në pyetje të dëshmitarit të njëjtë, dhe mund të përdoret si provë e drejtpërdrejt gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve, apo mos pranisë së tij

në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare e fajësisë për dënimin e të pandehurit.

Andaj mund të konkludojm, se kjo dispozitë trajton çështjen e mjaftueshmërisë së provave të siguruar gjatë procedurës paraprake, duke e trajtuar se një provë e tillë si e vetme nuk mund të përdoret për një vendim fajësie, por edhe aspekti tjetër se e relativizon deri në atë shkallë sa që nuk mund të jetë vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit.

Përfundimisht, edhe nën alternativën e supozimit të besueshmërisë së deklaratës së të dëmtuarës dhënë në procedurën hetimore, e njëjta në bazë të dispozitës së lartpërmendur do të ishte e pamjaftueshme për t'u përdorur për një vendim me epilog fajësie.

Standardi i të provuarit sipas KPP-së edhe pse nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite me leximin e dispozitës të nenit. 3 paragrafi.2, përcakton “se mëdyshjet e ekzistimit të fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit” , andaj në interpretimin *a contrario* nënkupton se faktet inkriminuese duhet të vërtetohen *përtej dyshimit të arsyeshëm (beyond reasonable doubt)*, rrjedhimisht në rastin konkret trupi gjyqës vlerëson se nga dëshmitë e veçanta dhe nga tërësia e tyre nuk është provuar akuza e prokurorisë për veprën penale Trafikimi me Njerëz nga neni 139 par. 1 KPK-së, dhe në bazë të nenit 364 par. 1.3 të KPP-së e liroi të akuzuarin ngase nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

5. Kërkesat Pasurore Juridike dhe Shpenzimet e procedurës Penale

E dëmtuara V. Sh nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike, ndërsa shpenzimet e procedurës penale në kuptim të nenit 454 të KPP-së bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PKR . Nr. 14/13, më 29 janar 2013

Procesmbajtësja:

Kryetari i trupit

gjykues:

Ardrita Ymeri

Bashkim Hyseni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.